



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT
TË MËSUESVE TË ARSIMIT FILLOR**

SHKURT, 2024

Koordinatorë

EDLIRA SINA & AURELA ZISI

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	3
II.	SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT	3
III.	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	4
3.1	Përmbajtja e programit orientues të zhvillimit profesional për mësuesit që do të marrin kategorinë e dytë dhe të tretë të kualifikimit	5
3.1.1	Fushat kryesore të zhvillimit profesional	5
3.1.2	Model i testit të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor	13
3.2	Orientime dhe udhëzime për kualifikimin e kandidatëve-mësues të arsimit fillor për marrjen e kategorisë së parë	22
3.2.1	Orientime rreth formatit të orës së hapur mësimore	22
3.2.2	Kriteret e vlerësimit të orës së hapur mësimore	28

I. HYRJE

Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta pune dhe etike. Mësuesi i arsimit fillor vepron me ndershmëri dhe integritet të lartë profesional, zotëron përmbytjen e lëndëve nga klasa e parë në të pestën, përditëson dijet dhe aftësitë profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme, krijon dhe pasuron sistematikisht portofolin e zhvillimit profesional, përfshihet në procesin e vetëvlerësimit, dokumenton vlerësimet që i bëhen, krijon marrëdhënie korrekte me prindërit në interesin më të mirë të fëmijëve dhe të shoqërisë.

Programi i zhvillimit profesional, për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të arsimit fillor që do të kandidojnë për marrjen e kategorive të kualifikimit;
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar trajnime me mësuesit e arsimit fillor që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MAS-it Nr.2, datë 8.2.2023 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.

II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT

Synimet e programit të zhvillimit profesional të mësuesve të arsimit fillor për marrjen e kategorive të kualifikimit janë:

- *të ndihmojë* çdo mësues që do të kualifikohet për kriteret që duhet të plotësojë dhe procedurat që duhet të ndjekë për të marrë kategorinë e kualifikimit;
- *të japë* orientime dhe udhëzime që kërkohen nga MAS-it për të ndihmuar të gjithë mësuesit e arsimit fillor që të krijojnë portofolin e zhvillimit profesional dhe të përgatiten në mënyrë cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar;
- *të lehtësojë* punën e DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar seancat e informimit dhe të trajnimit në lidhje me ndryshimin e procedurave për marrjen e kualifikimit nga mësuesit që do të kualifikohen për kategorinë e parë. Por, programi mund të plotësohet nga DRAP-et dhe ZVAP-et përkatëse, sipas kushteve dhe rasteve specifike.

Programi ka për qëllim që mësuesi i arsimit fillor që kandidon për marrjen e shkallëve të kualifikimit:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zbatojë rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe;
- të zhvillojë aftësitë e përdorimit të TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor është i organizuar në dy pjesë:

Pjesa e parë: Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë (Mësues specialist) dhe të tretë (Mësues i kualifikuar) të kualifikimit. Në këtë program përfshihen, fushat ku do të testohen kandidatët, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme për secilën kompetencë, si dhe literatura ku do të mbështeten për t'u përgatitur për testimin kombëtar. Gjithashtu, pjesë e kësaj është edhe një model testi i kualifikimit i arsimit fillor.

Pjesa e dytë: **Orientime dhe udhëzime për kualifikimin e kandidatëve të arsimit fillor për marrjen e kategorisë së parë (Mësues mjeshtrë)**. Në këtë pjesë të programit jepen udhëzime rreth formatit të temës së mësimi, kërkesat që duhen mbajtur parasysht nga çdo kandidat, si dhe kriteret e vlerësimit të orës së hapur të mësimi, të cilave do t'u referohen drejtuesi i shkollës, drejtuesi i rrjetit profesional dhe përfaqësuesi i ZVAP-it.

3.3 Përmbajtja e programit orientues të zhvillimit profesional për mësuesit që do të marrin kategorinë e dytë dhe të tretë të kualifikimit

Programi për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit përmban fushat ku do të testohen kandidatët, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme për secilën kompetencë, si dhe literaturën ku do të mbështeten për t'u përgatitur për testimin kombëtar. Gjithashtu, pjesë e kësaj është edhe një model testi i kualifikimit i arsimit fillor.

3.3.1 Fushat kryesore të zhvillimit profesional

Fushat kryesore në të cilat do të testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë janë:

- dokumentacioni zyrtar¹ shkollor;
- programet mësimore të të gjitha lëndëve të arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut gjatë mësimdhënies;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndëve në arsimin fillor, nga klasa e parë në të pestën.

FUSHAT	KOMPETENCAT
I. Dokumentacioni zyrtar shkollor	Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor.
II. Programe lëndore të arsimit fillor	Zbatimi në mënyrë efektive i programeve lëndore.
III. Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të Tik-ut në mësimdhënien e arsimit fillor	Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin fillor.

¹Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe i formave të ndryshme të punës me nxënësit e kësaj moshe, realizimi i integritetit ndërlëndor. 2. Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vëzhgimit dhe të vlerësimit të nxënësve.
IV. Aspekte të etikës dhe të komunikimit	Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit.
V. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
VI. Përmbajtja shkencore e lëndëve të arsimit fillor	Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndëve të ciklit fillor.

Për fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave. Gjithashtu, programi përmban literaturën rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushave/lëndëve të arsimit fillor.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përgatitet për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit.

FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR	
Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit fillor:</i> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. ▪ Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e

<p>Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<p>Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022). ▪ Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021. ▪ Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. ▪ Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. ▪ Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. ▪ Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	--

FUSHA: PROGRAME LËNDORE TË ARSIMIT FILLOR	
Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve lëndore”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit fillor:</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, 2014.

<ul style="list-style-type: none"> • <i>qëndron</i> i mirinformuar për të rejtat e reformës kurrikulare, pjesë e të cilës është edhe arsimit fillor; • <i>zbaton</i> programet lëndore duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre; • <i>përdor</i> me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetit të zbatimit të programeve lëndore dhe të integritit ndërlëndor; • <i>përdor</i> materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • <i>harton</i> objektiva (rezultate të nxëni) për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat (shkathtësitë) e programit; • <i>shpjegon</i> lidhjen program-tekst-plan mësimor vjetor dhe periudhash; • <i>planifikon</i> projekte kurrikulare; • <i>përzgjedh</i> mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programeve lëndore; • <i>harton</i> teste sipas kritereve të caktuara për të vlerësuar njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve në lëndë të ndryshme të ciklit fillor. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kurrikula bërthamë klasat KP-5, 2014. ▪ Programet lëndore për klasat 1-5. ▪ Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re në Arsimin Fillor, IZHA, 2018.
---	---

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIEN E ARSIMIT FILLOR

Kompetenca I

“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike

të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin fillor”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • është njohës i mirë i aspekteve didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të nxënies dhe i psikologjisë moshore të nxënësve me të cilët punon; • shfrytëzon literaturën bashkëkohore për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies; • analizon elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë llojet e mësimdhënies me njëra-tjetrën; • menaxhon situata, sjellje dhe veprime të ndryshme nxënësish; • zotëron aftësitë dhe kompetencat profesionale që i duhen mësuesit të ciklit fillor; • zhvillon mësimdhënie të diferencuar; • dallon vështirësinë në të nxënë nga aftësia e kufizuar; • harton plane edukative individuale (PEI); • krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënies; • planifikon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënies; • prezanton materiale didaktike duke përdorur programet më të njohura kompjuterike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Korniza kurrikulare, 2014. ▪ Kurrikula bërthamë AMU, klasat I-V, 2014. ▪ Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re në Arsimin Fillor, IZHA, 2018. ▪ Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxëniesit e tij.
<p align="center">Kompetenca II</p> <p>Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe i formave të ndryshme të punës me nxëniesit</p>	<p>Literaturë e rekomanduar</p>

<p>e kësaj moshe, realizimi i integritit ndërlëndor</p>	
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>motivon</i> nxënësit në forma e mënyra efektive; • <i>zbaton</i> metodat ndërvepruese të mësimdhënies në përshtatje me lëndën, temën e mësimin dhe me moshën e nxënësve; • <i>planifikon</i> veprimtari që nxisin të menduarit kritik e krijues të nxënësve; • <i>krijon</i> klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • <i>planifikon</i> orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • <i>përdor</i> metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • <i>përdor</i> metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të nxënit me situata, kompetenca dhe situata e të nxënit, IZHA 2014. ▪ Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. ▪ Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re në Arsimin Fillor, IZHA, 2018 ▪ Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënit, (arsimi fillor) klasa I-III dhe IV-V, IZHA, mars 2019. ▪ Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. ▪ Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021. ▪ Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, planifikimin e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara, hartimin e planit edukativ individual, disiplinimin pozitiv të sjelljes së nxënësve në klasë etj..
<p align="center">Kompetenca III</p> <p>Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vëzhgimit dhe të vlerësimit të nxënësve</p>	<p>Literaturë e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përdor</i> mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve; • <i>vëzhgon</i> dhe vlerëson me përshkrim 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Udhëzim nr. 4, datë 11.04.2016, “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”. ▪ Korniza e vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar, IZHA 2015. ▪ Nivelet e arritjes së kompetencave të

<p>ecurinë dhe përparimin e nxënësit, duke përdorur instrumente të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dokumenton</i> detyra e punime të nxënësve që dëshmojnë përparimin dhe interesin e tyre për shkollën dhe komunitetin përreth; • <i>punon</i> me prindërit për përmirësimin e përparimit të nxënësit. 	<p>fushave të të nxënësve, (arsimi fillor) klasa I-III dhe IV-V, IZHA, mars 2019.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. ▪ Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP, 2019.
---	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	
Kompetenca	Literatura
<p>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</p>	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>njuh</i> rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • <i>sillet</i> në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, më 30.11.2013. ▪ Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin e MAS-it, nr.31, datë 28.01.2020. ▪ Urdhri i MAS-it, nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
Kompetenca	Literatura
<p>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</p>	

<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe, në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar; • zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në çdo veprimtari në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.
--	---

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË ARSIMIT FILLOR

<p align="center">Kompetenca</p> <p align="center">Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndëve të ciklit fillor</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>zotëron</i> konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë në nivel shkencor dhe didaktik; • <i>transmeton</i> konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë dhe rregullat në përshtatje me moshën dhe të nxënësve; • <i>zotëron</i> njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që fitojnë nxënësit nga klasa 1-5 për çdo program lëndor; • <i>planifikon</i> sipas vështirësive tipike që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor; • <i>përshtat</i> programet lëndore për nxënësit që paraqesin vështirësi në të nxënë ose që janë me aftësi të kufizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të gjitha programet lëndore që përmban plani mësimor, klasat 1-5. ▪ Tekstet shkollore nga klasa 1-5. ▪ Botime të ndryshme në ndihmë të mësuesve dhe nxënësve.

3.3.2 Model i testit të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor

I. DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR

1. Bazuar në Udhëzimin për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve, kandidati për kualifikim ka të drejtë të ankohet me shkrim për vlerësimin e portofolit tek titullari i ZVAP-së: **1 pikë**
 - A) brenda 2 ditëve nga vlerësimi i portofolit.
 - B) brenda 3 ditëve nga vlerësimi i portofolit.
 - C) brenda 4 ditëve nga vlerësimi i portofolit.
 - D) brenda 5 ditëve nga vlerësimi i portofolit.

2. Përcaktoni cili nga standardet e mëposhtme bën pjesë në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar: **1 pikë**
 - A) Njohuri dhe aftësi për procesin krijues.
 - B) Përdorimi i burimeve historike.
 - C) Bashkëpunimi me komunitetin.
 - D) Ndërgjegjësimi i nxënësve për rëndësinë e komunikimit.

3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G): **2 pikë**
 - a) Institucioni arsimor funksionon sipas rregullores së tij të brendshme, e cila është në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera ligjore në fuqi, dhe miratohet nga titullari i institucionit arsimor. V/G __
 - b) Çdo institucion arsimor ka bordin e tij i cili miraton planin afatmesëm dhe vjetor të institucionit. V/G _____

II. PROGRAMET LËNDORE

4. _____ shprehin kriteret e njëjtësuar për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse. **1 pikë**
 - A) Nivelet e arritjes,
 - B) Kompetencat kyç,
 - C) Shkallët e kurrikulës,

D) Llojet e vlerësimit.

5. Lidhni me shigjetë.

4 pikë

Temat ndërkurrikulare 1 •	• a integrojnë fushat e të nxënit, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.
Veprimtaritë 2 • ekstrakurrikulare	• b janë veprimtaritë që planifikohen nga institucioni arsimor dhe kanë për qëllim pasurimin e përvojave mësimore e jetësore të nxënësve.
Veprimtaritë 3 • ndërkurrikulare	• c janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen.
Veprimtari plotësuese 4 •	• d janë veprimtari të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore formale, por që ndihmojnë arritjen e kompetencave për shkallët e kurrikulës dhe ciklet e arsimit.

6. Jepet rezultati i të nxënit “Nxënësi pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të”. Cilës kompetencë gjuhësore i përket ky rezultat? **1 pikë**

III. ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

7. _____ ka të përcaktuar temën, kohëzgjatjen, rezultatet e të nxënit, konceptet kryesore, veprimtaritë kryesore, partnerët, burimet, produktin kryesor dhe kriteret e vlerësimit: **1 pikë**

- A) Kurrikula me zgjedhje,
- B) Projekti kurrikular,
- C) Veprimtaria ekstrakurrikulare,
- D) Veprimtaria ndërkurrikulare.

8. Në arsimin fillor, _____i shërbejnë përshtatjes së fëmijëve me një formë më të sistemuar të të nxënit nëpërmjet lojës, punës, mësimit, si dhe aftësimit të tyre për të bërë dallimin mes lojës dhe detyrës. **1 pikë**

- A) përvojat mësimore
- B) metodat e mësimdhënies
- C) punët praktike
- D) detyrat shkencore

9. Në kuadrin e zhvillimit të kompetencës digjitale “nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin”. Jepni shembuj nga 2 lëndë të arsimit fillor nëpërmjet të cilëve përmbushet rezultati “Nxënësi realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre”. **3 pikë**

10. Plotësoni fjalinë. **1 pikë**

Zhvillimi i _____ bëhet në përputhje me kërkesat e nxënësve, kushtet e shkollës, specifikat rajonale, kërkesat e aktualitetit dhe domosdoshmërisht nënkupton njohje të mirë të të gjithë dokumentacionit kurrikular.

11. Jepet rezultati i të nxënit "Nxënësi shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit për një çështje të caktuar historike". Hartoni 3 nivelet e arritjes për vlerësimin e nxënësit për përmbushjen e këtij rezultati. **3 pikë**

Niveli 2

Niveli 3

Niveli 4

12. Zgjidhni një prej temave ndërkurrikulare (*Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, zhvillimi i qëndrueshëm, mjedisi, ndërvarësia, bashkëjetesa paqësore*) dhe tregoni një veprimtari të realizuar me nxënësit e klasës suaj.

4 pikë

IV. ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

13. Përgatitja e punonjësve arsimorë për të punuar në institucione dhe në mjedise gjithëpërfshirëse mbetet një prioritet i sistemit arsimor parauniversitar. Arsimi gjithëpërfshirës i përgjigjet një sistemi arsimor që:

1 pikë

- A) nxit veçimin dhe izolimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- B) thekson nevojën për të nxitur më shumë edukimin e djemve.
- C) inkurajon arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta përmes shkollave speciale.
- D) siguron përfshirjen e të gjithë fëmijëve, pavarësisht nga kushtet fizike, intelektuale, shoqërore, gjuhësore ose kushte të tjera të ndryshme.

14. Referuar Kodit të etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar, përmendni dy ndër detyrat e Komisionit të etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor:

2 pikë

- a) _____
- b) _____

V. ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**
- A) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka.
- B) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.
- C) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me Raportin Mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.
- D) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me Raportin Mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.
16. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), fjalitë e mëposhtme. **3 pikë**
- a) Zhvillimi i vazhdushëm profesional i mësuesit mbetet kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve të synuara. ____
- b) Qëllimi kryesor i vlerësimit është të përmirësoj të nxënit dhe të nxjerrë në pah rezultatet e tij. ____
- c) Udhëzuesit kurrikularë ndihmojnë në zbatimin e unifikuar të politikës kurrikulare në të gjitha fazat e zbatimit të saj. ____

VI. PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË ARSIMIT FILLOR

“Dashuria për vendin tënd”

Po udhëtojmë drejt Adriatikut. Kemi bërë një udhë shumë të gjatë, duke ndërruar shumë avionë nëpër aeroporte të ndryshme e të çuditshme. Gjumin e kemi bërë copa-copa, duke fluturuar mbi qytete të panjohura. Para se të mbërrijmë në Shqipëri ndalemi për pak ditë në Romë. Shëtisim nëpër rrugët e Romës. Është ftohtë. Nëntor. Udhëtimi nëpër kryeqytet sa vjen e bëhet më interesant. Befas syri ndalon tek një tabelë: Rruga “Gjergj Kastrioti”.

Një rrugë me mbishkrimin: “Këtu ka bujtur disa ditë Gjergj Kastrioti”. Ne nuk flasim fare. Mendohemi. Këtu ai erdhi pesë shekuj më parë. Zbriti nga kali dhe hyri te kjo ndërtesë. Banorët rreth e rrotull dolën në dritare për të parë mysafirin e huaj dhe të largët. Ai vinte nga një vend ku bëhej luftë e tmerrshme. Në dhomat e tij kish dritë gjer vonë. Mendohemi rreth asaj kohe, ndërsa shiu bie pa pushim. Hipim në makinë e largohemi në rrugët e pafund të qytetit. Nesër do të

nisemi në Shqipëri. Avioni do ta lërë pas detin Adriatik. Poshtë reve, poshtë mjegullës, midis luginës së bukur, si një e njohur e vjetër, do të na shfaqet pista e aeroportit të Rinasit.

Mirë se të gjejmë, Atdhe!

Ismail Kadare

17. Nëpërmjet këtij fragmenti tregimtari ka për qëllim të rrëfejë: **1 pikë**

- A) udhëtimin e tij të radhës.
- B) peripecitë e papritura gjatë udhëtimit.
- C) vendet që i kanë bërë më shumë përshtypje.
- D) vendet që mbajnë emrin e heroit Gjergj Kastriot Skënderbeut.

18. Ky fragment ka elemente: **1 pikë**

- A) shkencore.
- B) biografike.
- C) informues.
- D) autobiografike.

19. Në fjalinë “Këtu ka bujtur disa ditë Gjergj Kastrioti”, fjala e nënvizuar tregon: **1 pikë**

- A) ka jetuar përgjithmonë.
- B) është strehuar për një periudhë kohe.
- C) ka banuar për një kohë të shkurtër.
- D) ka qenë i ftuar.

20. Në fjalinë “Gjumin e kemi bërë copa-copa, duke fluturuar mbi qytete të ndryshme”, pjesa e nënvizuar tregon se: **1 pikë**

- A) kemi fjetur keq.
- B) kemi fjetur pak.
- C) nuk kemi vënë gjumë në sy.
- D) kemi fjetur top.

21. Në fjalinë “ Po udhëtojmë drejt Adriatikut”, kryefjala është: **1 pikë**

- A) e shprehur qartë.
- B) e nënkuptuar.
- C) veta e parë, numri njëjës.
- D) veta e tretë, numri shumës.

22. Në fjalinë “Është ftohtë” fjala *ftohtë* është: **1 pikë**

- A) kallëzues emëror.
- B) kallëzues foljor.
- C) rrethanor.
- D) kundrinor.

23. Çfarë ndjesie ju dha mbyllja e këtij fragmenti. Argumentoni përgjigjen. **2 pikë**

24. Plotësoni fjalitë. **3 pikë**

- a) Në fjalinë e përbërë “Ai vinte nga një vend ku bëhej luftë e tmerrshme”, lidhëza *ku* është__.
- b) Në fjalinë “Poshtë reve, poshtë mjegullës, midis luginës së bukur, si një e njohur e vjetër, do të na shfaqet pista e aeroportit të Rinasit”, figura letrare e përdorur është _____.
- c) Forma e pashtjelluar e foljes duke fluturuar është _____.

25. Listoni konceptet kryesore që marrin nxënësit në tematikën “Historia ime dhe e familjes sime”. **3 pikë**

26. Si do ta realizoni një teatër me maska? Jepni shembull nga një shfaqje e realizuar me nxënësit tuaj.

2 pikë

27. Lugët plastike vendosen në kuti me nga 6 copë, pirunët plastike në kuti me nga 8 copë dhe thikat plastike në kuti me nga 12 copë. Cili është numri më i vogël i kutive me lugë, me pirunë dhe me thika që të formohen komplete me të tria këto mjete?

3 pikë

28. Një depozitë uji është e mbushur 30% të kapacitetit të saj. Duke shtuar dhe 35 litra ujë ajo mbushet me 80% të kapacitetit. Sa është kapaciteti i depozitës?

3 pikë

29. Nëpërmjet situatave të të nxënit nga jeta reale tregoni si do ta kuptojnë nxënësit se: **3 pikë**

a) Ngjarjet kanë një shkak.

b) Ngjarjet sjellin pasoja.

c) Ngjarjet janë të mira dhe të këqija.

30. Në boshtin numerik, kur nisemi nga numri 3 dhe zhvendosemi majtas 5 njësi arrijmë te numri _____.

1 pikë

31. Vepra të ndryshme arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme lidhen me historinë e artit. Tregoni për një vepër arti të realizuar nga artistë të zonës/krahinës suaj.

3 pikë

32. Gjatësitë e brinjëve të një drejtkëndëshi janë dy numra të njëpasnjëshëm. Sipërfaqja e drejtkëndëshit është 72 cm^2 . Cilat janë gjatësitë e brinjëve të tij?

3 pikë

33. Gjeni vlerën e shprehjes $14 \times 4 - 50 : 2 + 3 (12 - 6 : 2 + 7 \times 3)$.

2 pikë

34. Plotësoni vendet bosh.

3 pikë

_____ është një teknikë në pikturë. _____ janë bojëra të tretshme

në ujë. _____ që përdoren në këtë teknikë janë me fije të holla dhe të buta.

35. Cili numër duhet vendosur në vend të pikëpyetjes që barazimi të jetë i vërtetë?

1 pikë

$$104,25 = 100 + 4 + \frac{1}{5} + \frac{1}{?}$$

36. Tregoni qëndrimet dhe vlerat që fitojnë nxënësit kur tregojnë çfarë *mund* dhe *duhet* të bëjnë ata dhe banorët e tjerë të komunitetit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe përfitimet prej tyre.

2 pikë

a) _____

b) _____

3.4. Orientime dhe udhëzime për kualifikimin e kandidatëve-mësues të arsimit fillor për marrjen e kategorisë së parë

Sipas Nenit 2 “Organizimi i procesit të kualifikimit” të Udhëzimit nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, në pikën 2 të tij shkruhet se procesi i kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër), kryhet nëpërmjet portofolit të zhvillimit profesional të mësuesve dhe provimit të realizuar me orë mësimore të hapur në lëndën/profilin dhe ciklin përkatës.

Mësimdhënia dhe të nxënit me kompetenca kërkon mësues cilësisht të aftë për të lehtësuar të nxënit e nxënësve, të përkushtuar ndaj tyre dhe nevojave që kanë, si dhe për t’iu siguruar strategji, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë të nxënit sa më efektiv.

Në përgatitjen e orës së hapur mësimore, mësuesi i kategorisë së parë duhet të demonstrojë zotërimin e përmbajtjes shkencore të lëndëve që zhvillohen në arsimin fillor, të ndërtojë një mjedis gjithëpërfshirës ku çdo nxënës ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur, të krijojë një klimë pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv, ku fëmijët pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin, të dëshmojë interesimin e tij për t’u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies me qëllim zbatimin cilësor të kërkesave të reja kurrikulare, të përdorë metoda e instrumente të larmishme të vlerësimit për të nxënit dhe të të nxënit të nxënësve.

3.4.1 Orientime rreth formatit të orës së hapur mësimore

Në këtë pjesë të programit jepen udhëzime rreth formatit të temës së mësimit, kërkesat që duhen mbajtur parasysh nga çdo kandidat, si dhe kriteret e vlerësimit të orës së hapur të mësimit, të cilave do t’u referohen drejtuesi i shkollës, drejtuesi i rrjetit profesional dhe përfaqësuesi i ZVAP-it.

Mësuesi është i lirë ta zgjedhë lëndën dhe temën e mësimit, të cilën do ta zhvillojë me nxënësit e klasës së tij. Gjithashtu, ai është i lirë ta zgjedhë vetë edhe mjedisin ku do ta zhvillojë mësimin me nxënësit për atë orë mësimi. Mësuesi do të vlerësohet:

- për respektimin e rubrikave të formatit të planifikimi ditor, si dhe
- për zbatimin praktik të këtij plani me nxënësit e klasës.

Gjatë trajnimeve për zbatimin e kurrikulës së re, mësuesit janë njohur edhe me formatin e ri të planifikimit vjetor, planifikimit të periudhës dhe planifikimit ditor.

Formati për planifikimin ditor sipas kurrikulës me kompetenca përmban rubrika të përcaktuara. Mësuesi është i lirë t'i organizojë këto rubrika në mënyrën që i duken më efektive. Në vijim renditen të gjitha rubrikat dhe jepen orientime dhe udhëzime që do ta ndihmojnë mësuesin të bëjë një planifikim sa më të mirë të temës mësimore, duke përfshirë risitë metodologjike për realizimin e rezultateve të të nxënit, si dhe risitë në procesin e të nxënit (Neni 17 i Udhëzimit, Pika 1).

Formati i planifikimit të temës mësimore

Lënda	➔	Shënohet emërtimi i lëndës në të cilën do të zhvillohet ora e hapur mësimore.
Tema mësimore	➔	Shënohet tema e mësimit për atë orë mësimore.
Rezultatet e të nxënit	➔	Shkruhen rezultatet e të nxënit për këtë temë mësimore. Rezultatet duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme dhe të kuptueshme për atë që pritet të demonstron se është arritur nga nxënësi.
Konceptet kyç/ fjalët kryesore	➔	Shënohen konceptet kyç dhe fjalët kryesore që do të trajtohen gjatë zhvillimit të orës së mësimit.
Situata e të nxënit	➔	Përdorimi i situatave të të nxënit është një nga risitë e zbatimit të kurrikulës me kompetenca. Situata e të nxënit është e lidhur me veprimtari praktike që nxënësi zhvillon në klasë, ose një situatë e simuluar që lidhet me temën e mësimit.
Burimet, materialet dhe mjetet didaktike	➔	Shënohen burimet e literaturës, materialet ndihmëse dhe mjetet didaktike që i duhen mësuesit dhe nxënësve gjatë zhvillimit të orës së mësimit.
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare	➔	Kjo rubrikë plotësohet kur tema e mësimit ka lidhje me njohuri nga lëndë të tjera të arsimit fillor ose me një nga temat ndërkurrikulare. Në raste të tilla,

		veprimtari lidhëse shënohet këtu, kurse integrimi me temën e mësimit trajtohet në rubrikën “Ecuria e zhvillimit të mësimit”.
Ecuria e zhvillimit të mësimit	➔	Mësuesi shënon hap pas hapi të gjitha veprimtaritë që do të kryejë gjatë orës së mësimit. Gjithashtu në këtë rubrikë, mësuesi shënon veprimtaritë dhe metodat që do të përdoren prej tij dhe prej nxënësve të klasës. Pjesë e kësaj rubrike janë edhe mjetet digjitale që do të përdoren gjatë orës së mësimit.
Vlerësimi	➔	Mësuesi shënon për çfarë do t’i vlerësojë nxënësit apo për çfarë do të mbajë shënime vlerësuese gjatë zhvillimit të mësimit. Në kurrikulën e re, mësuesi përpiqet që gjatë gjithë kohës së mësimit t’i vendosë nxënësit në veprimtari praktike dhe në situata të tilla që ata të veprojnë e të demonstrojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënit. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi ndjek performancën e secilit prej tyre dhe bën vlerësime rreth saj.
Detyra	➔	Shënohen ushtrimet, kërkesat, temat, titujt e detyrave që do t’u jepen nxënësve për të punuar në shtëpi. Detyrat mund të jenë individuale ose në grup dhe t’u përgjigjen stileve të ndryshme të të nxënit.

Në shtojcën 1 të Udhëzimit nr.2, datë 8.2.2023 të kualifikimit të mësuesve jepet “Formati i instrumentit për vlerësimin e orës së hapur, i cili përmban; treguesit e cilësisë, përshkruesit, totalin e pikëve për secilin përshkrues dhe nivelet e vlerësimit.

Treguesi 1: Planifikimi i orës së hapur mësimore (10 pikë)

Përshkruesi 1. Mësuesi planifikon të gjithë **komponentët e orës së mësimit** në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënit (5 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- përmbushjen e kriterëve të shkrimit të rezultateve të të nxënimit të temës së mësimimit;
- përshtatjen e situatës së të nxënimit me përmbajtjen e temës së mësimimit;
- për përzgjedhjen e materialeve dhe të mjeteve të përshtatshme për temën e mësimimit;
- për qartësinë e hapave që do të ndjekë për zhvillimin e orës së mësimimit;
- mbajtjen parasysh të stileve të ndryshme të të nxënimit.

Përshkruesi 2: Mësuesi planifikon temën e mësimimit me qasje të re inovative që lidhet me demonstrimin e kompetencave të të nxënimit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore (5 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- qasjen e re inovative që ka sjellë në zhvillimin e temës së mësimimit;
- veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënimit gjatë gjithë jetës;
- veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e kompetencave lëndore.

Treguesi 2: Mjedisi i të nxënimit (14 pikë)

Përshkruesi 1. Mësuesi krijon një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe. (7 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- klimën që ka krijuar në klasë, ndërmjet tij dhe nxënësve të klasës dhe ndërmjet nxënësve në marrëdhënie me njëri-tjetrin;
- lirshmërinë që kanë nxënësit për të shfaqur mendimet dhe idetë e tyre për pyetje, situata dhe veprimtari të ndryshme;
- komunikimin dhe marrëdhëniet që kanë nxënësit ndaj njëri-tjetrit në situata, momente dhe veprimtari të ndryshme që zhvillohen në klasë.

Përshkruesi 2. Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndër marrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.(7 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- drejtimin në emër të çdo nxënësi të klasës;
- përfshirjen e të gjithë nxënësve gjatë orës së mësimimit;

- përgjigjet që u jep pyetjeve të nxënësve;
- vëmendjen që i kushton çdo nxënësi që ka nevojë;
- qetësinë që ruan në situata të vështira që kanë ndodhur gjatë orës së mësimit;
- përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe të nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë.

Treguesi 3: Metodatat mësimore (21 pikë)

Përshkruesi 1. Mësuesi i organizon nxënësit në varësi të metodave dhe stileve të të nxënit.
(7 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- përdorimin e metodave ndërvepruese të mësimdhënies;
- organizimin e nxënësve në veprimtari që lidhen me stilet e tyre të të nxënit;
- mundësitë që i jep çdo nxënësi për të kryer me sukses veprimtaritë e planifikuara.

Përshkruesi 2. Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin.
(7 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- përdorimin e metodave dhe të teknikave që nxisin të menduarit kritik të nxënësve;
- përdorimin e metodave që nxisin zgjidhje origjinale dhe stimulojnë aftësitë krijuese të nxënësve;
- temat, çështjet dhe rastet që sjellë para nxënësve, të cilat nxisin biseda, diskutime dhe shprehjen e mendimeve të ndryshme.

Përshkruesi 3. Mësuesi formulon pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme duke nxitur nxënësit të bëjnë pyetje përgjatë orës së mësimit. (7 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- cilësinë e pyetjeve që u drejton nxënësve;
- larminë e pyetjeve, mbështetur në Taksonominë e Blumit, por jo vetëm;
- nxitjen e nxënësve për të bërë pyetje rreth asaj që dëgjojnë.
- kohën që u lë nxënësve të përgjigjen në varësi të llojit/ nivelit të pyetjes që bëhet.

Treguesi 4: Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)

Përshkruesi 1. Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e tij të nxënies. (7 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- përmbushjen e rezultateve të të nxënësit nga ana e nxënësve;
- mundësitë që iu krijuan çdo nxënësi për të treguar se çfarë mësoi nga ora e mësimit;
- qartësinë e nxënësve në kryerjen e detyrave dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e veprimtarive gjatë orës së mësimit;
- analizën që bën në lidhje me arritjet e nxënësve të klasës.

Përshkruesi 2. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes. (5 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- përshtatjen e teknikës së vlerësimit me veprimtarinë për të cilën i jepet nxënësit vlerësimi;
- larminë e teknikave të vlerësimit të nxënësve;
- nxitjen e vetëbesimit të nxënësve;
- motivimin e nxënësve për t'u përfshirë dhe për të përfunduar çdo detyrë;
- për vlerësimin nga njëri-tjetri të nxënësve, sidomos pas punës në grup.

Përshkruesi 3. Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve. (5 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- përshtatjen e mësimdhënies dhe të veprimtarive sipas nevojave të nxënësve;
- përfshirjen e nxënësve në veprimtari, të cilat ata mund t'i kryejnë dhe të përmbushin rezultatet e të nxënësit.

Treguesi 5: Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)

Përshkruesi 1. Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore. (4 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- sigurimin e materialeve dhe mjeteve të planifikuara për temën e mësimit;

- konkretizimin e mësimit me mjete mësimore dhe didaktike të përshtatshme për temën e mësimit.

Përshkruesi 2. Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.
(4 pikë)

Mësuesi vlerësohet për:

- sigurimin e pajisjeve dhe të mjeteve digjitale dhe përdorimin e tyre gjatë zhvillimit të orës së mësimit;
- nxitjen e nxënësve për të përdorur aftësitë digjitale në kryerjen e detyrave të klasës ose të shtëpisë.

3.2.2. Kriteret e vlerësimit të orës së hapur mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës së hapur mësimore:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës së hapur të mësimit, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive, të identifikojnë anët pozitive në zhvillimin e orës së mësimit dhe të përmirësojnë mësimdhënien në të ardhmen.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur				
Gjithsej 70 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 (Dobët)	Niveli 2 (Mjaftueshëm)	Niveli 3 (Mirë)	Niveli 4 (Shumë mirë)
Planifikimi i orës së hapur mësimore (10 pikë)				
Mësuesi ka	0 – 1 pikë	2 – 3 pikë	4 pikë	5 pikë
planifikuar të gjithë komponentët e	<i>Planifikimi i temës së mësimit nuk është i plotë,</i>	<i>Mësuesi ka zbatuar pjesërisht kërkesat e</i>	<i>Mësuesi ka zbatuar pothuajse plotësisht kërkesat</i>	<i>Mësuesi ka zbatuar me korrektësi kërkesat</i>

<p>orës së mësimit në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënit</p>	<p><i>organizimi i mësimit nuk është i qartë, rezultatet e të nxënit nuk kanë lidhje të ngushtë me temën e mësimit. Mungon situata e të nxënit dhe veprimtaritë nuk janë të lidhura me stilet e të nxënit. Mungon qartësia në renditjen e veprimtarive nga njëra etapë e mësimit në tjetrën.</i></p>	<p><i>planifikimit të temës mësimore. Situata e të nxënit nuk është e qartë. Veprimtaritë nuk janë të lidhura plotësisht me rezultatet e të nxënit. Planifikimi ka nevojë për një organizim më të mirë të veprimtarive dhe lidhjes së tyre me stilet e të nxënit.</i></p>	<p><i>e planifikimit të temës mësimore. Rezultatet e të nxënit plotësojnë kriteret e shkrimit të tyre. Situata e të nxënit mundëson konkretizimin e mësimit dhe është e përshtatshme për temën e mësimit. Mësuesi është përpjekur të bëjë një planifikim të mirë, por janë lënë hapësira për një renditje më të mirë të veprimtarive dhe përshtatje të tyre me stilet e të nxënit.</i></p>	<p><i>e planifikimit të temës mësimore. Rezultatet e të nxënit janë shkruar në mënyrë korrekte. Situata e të nxënit mundëson konkretizimin e mësimit dhe lehtëson të nxënit e temës së mësimit nga nxënësit e klasës. Planifikimi ka një rrjedhë logjike dhe qartësi në kalimin nga njëra etapë e orës së mësimit në tjetrën. Gjatë planifikimit të veprimtarive, mësuesi ka mbajtur parasysh stile të ndryshme të të nxënit.</i></p>
<p>Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me</p>	<p>0 – 1 pikë</p> <p><i>Planifikimi i mësuesit nuk përbën qasje inovative për mësime të mësimdhënien në arsimin fillor.</i></p>	<p>2 – 3 pikë</p> <p><i>Planifikimi i mësuesit ka pak përpjekje për të sjellë qasje inovative për mësime të mësimdhënien në</i></p>	<p>4 pikë</p> <p><i>Mësuesi ka realizuar një planifikim të kujdesshëm, me elementë inovativë për</i></p>	<p>5 pikë</p> <p><i>Mësuesi ka realizuar një planifikim të kujdesshëm, e cila sjell rrisje në zhvillimin e</i></p>

demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore	Veprimtaritë e zhvilluara nuk synojnë përmbushjen e kompetencave kyç. Deri diku ato mundet të zhvillojnë te nxënësit kompetencat lëndore.	arsimin fillor. Veprimtaritë e zhvilluara gjatë orës së mësimit kanë lidhje të dobëta me kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, veprimtaritë e zhvilluara tentojnë deri diku të zhvillojnë te nxënësit kompetencat lëndore.	mësimdhënien në arsimin fillor. Veprimtaritë e zhvilluara gjatë orës së mësimit kanë lidhje me kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, veprimtaritë u krijojnë mundësi nxënësve të zhvillojnë kompetencat lëndore.	mësimdhënies në arsimin fillor. Veprimtaritë e çdo etape të orës së mësimit nxisin te nxënësit shprehitë e komunikimit efektiv, të menduarit kritik e krijues dhe dëshirën e të nxënit gjatë gjithë jetës. Gjithashtu planifikimi ka mbajtur parasysh edhe zhvillimin e kompetencave lëndore.
---	---	--	--	---

Mjedisi i të nxënit (14 pikë)

Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet tyre, respektojnë njëri-tjetrin	0 – 1 pikë	2 – 3 pikë	4 – 5 pikë	6 – 7 pikë
	Mjedisit të klasës i mungon klima pozitive. Edhe pse përpiqet, mësuesi nuk arrin t'i përfshijë të gjithë nxënësit. Disa nxënës dominojnë mbi pjesën tjetër të klasës. Në përgjithësi pyetjet	Mjedisi i klasës ka nevojë për klimë më pozitive. Edhe pse përpiqet, mësuesi nuk arrin t'i përfshijë të gjithë nxënësit. Disa nxënës dominojnë mbi pjesën tjetër të klasës. Në	Në klasë ndihet klima pozitive dhe fakti që nxënësit ndihen mirë. Ka raste kur mësuesi bën diferencime dhe aktivizon më shumë disa nxënës. Mësuesi përpiqet të pyesë dhe të përfshijë në	Në klasë ndihet klima pozitive dhe mbështetësi që mësuesi ka me nxënësit e klasës. Gjatë gjithë kohës, mësuesi i ka trajtuar fëmijët në mënyrë të barabartë, duke u kushtuar vëmendje, duke i

<p>dhe pranojnë mendimin ndryshe.</p>	<p>edhe pse u drejtohen të gjithë nxënësve, për përgjigjet nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Nxënësit mbrojnë mendimet që shfaqin dhe nuk reagojnë pozitivisht ndaj mendimit ndryshe. Nxënësit shprehin mendime vetëm kur pyeten nga mësuesi.</p>	<p>përgjithësi pyetjet edhe pse u drejtohen të gjithë nxënësve, për përgjigjet nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Nxënësit mbrojnë mendimet që shfaqin dhe nuk reagojnë pozitivisht ndaj mendimit ndryshe. Nxënësit shprehin mendime kur pyeten nga mësuesi.</p>	<p>veprimtari të gjithë nxënësit e klasës. Në përgjithësi nxënësit reagojnë mirë ndaj mendimit ndryshe. Mësuesi u kushton vëmendje të gjithë nxënësve, por më tepër fëmijëve dhe i nxit të shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre për situata dhe veprimtari që zhvillohen në klasë.</p>	<p>pyetur dhe përfshirë në veprimtari të cilat ata i kanë kryer deri në fund. Nxënësit kanë marrëdhënie të shëndetshme me njëri-tjetrin dhe reagojnë pozitivisht edhe kur ndërmjet tyre shfaqen mendime ndryshe. Nxënësit i shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre për pyetje, situata dhe veprimtari që zhvillohen në klasë.</p>
<p>Mësuesi</p>	<p>0 – 1 pikë</p>	<p>2 – 3 pikë</p>	<p>4 – 5 pikë</p>	<p>6 – 7 pikë</p>
<p>angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje</p>	<p>Mësuesi paraqet vështirësi në përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve në veprimtaritë e planifikuara. Mungojnë iniciativat dhe në përgjithësi</p>	<p>Mësuesi përpiqet t'i përfshijë nxënësit në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në klasë. Mungojnë iniciativat dhe në përgjithësi nxënësit veprojnë</p>	<p>Në përgjithësi, mësuesi u drejtohet nxënësve me emër. Në pjesën më të madhe të kohës, çdo nxënës është i përfshirë në veprimtaritë që zhvillohen në</p>	<p>Në çdo rast mësuesi u drejtohet nxënësve me emër. Të gjithë nxënësit e klasës u përfshinë në mënyra, detyra dhe veprimtari të ndryshme, të cilat ishin planifikuar</p>

<p>me kujdes.</p>	<p>nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve që u jep mësuesi. Mësuesi nuk nxit diskutime mes nxënësve dhe pothuajse në çdo rast është ai që drejton mësimin, bisedën dhe veprimtarinë. Herë-herë bie në sy prirja e mësuesit për të përfshirë në mësim nxënësit me aftësi të kufizuar, duke mos u dhënë të njëjtën vëmendje nxënësve të tjerë të klasës.</p>	<p>sipas detyrave që u jep mësuesi. Mësuesi nuk nxit diskutimin mes nxënësve dhe pothuajse në çdo rast është ai që drejton mësimin, bisedën dhe veprimtarinë. Herë-herë bie në sy prirja e mësuesit për të përfshirë në mësim nxënësit me aftësi të kufizuar, duke mos u dhënë të njëjtën vëmendje nxënësve të tjerë të klasës.</p>	<p>klasë. Nxënës të veçantë kërkojnë të marrin iniciativa në kryerjen e detyrave të ndryshme. Në përgjithësi, pyetjeve të nxënësve u përgjigjet vetë mësuesi dhe rrallë përfshin nxënësit e tjerë. Kujdeset për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe të nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë.</p>	<p>kujdesshëm nga mësuesi. Nxënësit sillen natyrshëm dhe përfshihen në nisma, bëjnë pyetje dhe përfundojnë çdo detyrë që u jepet. Mësuesi vetë ose nëpërmjet nxënësve të tjerë u përgjigjet pyetjeve që bëjnë nxënësit. Menaxhon situatat e vështira/të papritura dhe e ka klasën në kontroll. Kujdeset për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe të nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë.</p>
--------------------------	--	---	---	---

Metodat mësimore (21 pikë)

Mësuesi	0 – 1 pikë	2 – 3 pikë	4 – 5 pikë	6 – 7 pikë
<p>organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe</p>	<p>Mësuesi përdor metoda që nxisin punën individuale dhe jo bashkëpunimin e</p>	<p>Mësuesi ndërthur metodat tradicionale me metodat ndërvepruese</p>	<p>Mësuesi zbaton disa metoda ndërvepruese gjatë mësimdhënies. Në punën e nxënësve</p>	<p>Mësuesi zbaton metoda ndërvepruese të mësimdhënies. Veprimtaritë</p>

<p>stileve të të nxënit</p>	<p>nxënësve, ndërveprimin dhe të nxënët në bashkëpunim. Mbizotëron shpjegimi i mësuesit dhe jo përfshirja e nxënësve në ndërtimin e njohurive. Nxënësit nuk përqendrohen në detyrën që u jep mësuesi, por kërkojnë vazhdimisht konfirmimin e tij në kryerjen e detyrave.</p>	<p>gjatë mësimdhënies. Në përgjithësi mbizotëron puna individuale dhe jo puna në grup. Nxënësit paraqesin vështirësi për të punuar të pavarur. Ata janë të varur nga mësuesi, pyesin dhe kërkojnë punojnë vetë dhe kërkojnë konfirmimin e tij në kryerjen e detyrave.</p>	<p>mbizotëron puna në grup, e cila jo në çdo rast nxjerr në pah punën individuale. Nxënësit punojnë vetë dhe kërkojnë ndihmë kur e ndiejnë të nevojshme.</p>	<p>rrjedhin natyrshëm dhe stimulojnë stile të ndryshme të nxëni. Format e organizimit të punës së nxënësve janë të larmishme dhe ata ndihen mirë në secilën prej tyre. Çdo nxënës përpiket të kryejë saktë detyrën e ngarkuar dhe të punojë me përgjegjësi.</p>
<p>Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin)</p>	<p>0 – 1 pikë</p> <p>Metodat që përdor mësuesi nuk nxisin të menduarit e nxënësve, por vetëm riprodhime të informacioneve që trajtohen në mësim. Mungon kërkesa e mësuesit për</p>	<p>2 – 3 pikë</p> <p>Mësuesi drejton pyetje që nxisin të menduarit e nxënësve, por pa kërkuar të analizojnë, të përgjithësojnë apo të nxjerrin mësimet e përfundime për situatat e dhëna. Herë-herë</p>	<p>4 – 5 pikë</p> <p>Mësuesi përdor disa metoda dhe teknika të cilat nxisin të menduarit kritik të nxënësve. Në disa raste mësuesi nxit dhënien e zgjidhjeve origjinale dhe mbajtjen e qëndrimeve</p>	<p>6 – 7 pikë</p> <p>Mësuesi përdor metoda dhe teknika që nxisin të menduarit kritik të nxënësve dhe zgjidhje origjinale të situatave të ndryshme. Gjithashtu, metodat e mësimdhënies stimulojnë</p>

	<p>nxënësit që të japin ide dhe zgjidhje origjinale. Detyrat që kryejnë nuk i nxisin nxënësve të menduarit dhe aftësitë e tyre krijuese. Diskutimet janë të vakëta dhe mbyllën shpejt, me mungesë argumentesh.</p>	<p>mësuesi i nxit nxënësit të japin zgjidhje origjinale dhe të mbajnë qëndrime individuale. Gjithashtu, metodat e mësimdhënies stimulojnë deri diku zhvillimin e aftësive krijuese të nxënësve. Më tepër, mësuesi zhvillon biseda, sesa diskutime për dhënie mendimesh të ndryshme.</p>	<p>individuale të nxënësve në situatat e dhëna. Gjithashtu, metodat e mësimdhënies stimulojnë deri diku zhvillimin e aftësive krijuese të nxënësve. Mësuesi përpiqet të ndezë në klasë diskutime për t'i përfshirë nxënësit në trajtimin e pyetjeve dhe të çështjeve që po diskutohen.</p>	<p>zhvillimin e aftësive krijuese të nxënësve dhe integrimin ndërlëndor. Temat, çështjet, pyetjet dhe rastet që sjell para nxënësve, nxisin biseda, diskutime dhe shprehjen e mendimeve të ndryshme të nxënësve.</p>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimt	0 – 1 pikë	2 – 3 pikë	4 – 5 pikë	6 – 7 pikë
	<p>Mësuesi drejton kryesisht pyetje që kërkojnë nga nxënësit riprodhimin e informacionit. Mungojnë pyetje që nxisin nivelet e larta të të menduarit dhe sidomos pyetjet vlerësuese dhe krijuese.</p>	<p>Mësuesi u drejton nxënësve pyetje kryesisht të nivelit bazë dhe mesatar të Taksonomisë së Blumit. Mësuesi i nxit nxënësit t'i bëjnë pyetje, por duket që ato nuk janë praktikë e përditshme në</p>	<p>Mësuesi u drejton nxënësve pyetje të niveleve të ndryshme të Taksonomisë së Blumit, por në përgjithësi mbizotërojnë pyetjet e nivelit mesatar të të menduarit. Vazhdimisht mësuesi i nxit</p>	<p>Mësuesi u drejton nxënësve pyetje të niveleve të ndryshme të Taksonomisë së Blumit. Pyetjet fillojnë nga niveli bazë, mesatar dhe shkojnë deri te niveli i lartë i të menduarit. Gjithashtu, mësuesi i nxit</p>

Pyetjet e mësuesit janë në përgjithësi të mbyllura dhe jo të hapura. Mungojnë - pyetjet e drejtuara nga nxënësit.	këtë klasë. Mësuesi nuk diferencon kohën që u duhet nxënësve për t'u përgjigjur në varësi të llojit të pyetjeve që u drejton.	nxënësit të bëjnë pyetje. Mësuesi u lë kohë nxënësve të mendohen para se të përgjigjen, por herë-herë ajo nuk mjafton dhe nxënësit nuk e shprehin të plotë mendimin që kanë. Mësuesi drejton pyetje të hapura nëpërmjet të cilave nxit qëndrime e veprime individuale të nxënësve.	nxënësit t'i drejtojnë atij pyetje, por edhe nxënësve të tjerë të klasës. Në varësi të nivelit të pyetjes, mësuesi u lë kohë nxënësve të mendohen para se të përgjigjen. Pjesa më e madhe e pyetjeve janë të hapura dhe lidhen me qëndrime e veprime individuale të nxënësve.
---	---	--	---

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)

Mësuesi	0 – 1 pikë	2 – 3 pikë	4 – 5 pikë	6 – 7 pikë
vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij	Mësuesi bën vlerësime të nxënësve për veprimtaritë e zhvilluara, detyrat e kryera. Të gjitha vlerësimet janë të shkurtra dhe nuk nxjerrin në dukje vështirësitë e nxënësve dhe	Vlerësimi i mësuesit është i përqendruar vetëm në ato veprimtari që kanë lidhje me përmirësimin e rezultateve të nxënimit të temës së mësimin. Edhe pse i pyet, nxënësit	Vlerësimi i mësuesit është i përqendruar te përmirësimi i rezultateve të nxënimit të temës mësimore. Mësuesi i pyet vazhdimisht nxënësit nëse kanë diçka të paqartë apo të pakuptuar	Mësuesi i vlerëson nxënësit për përmirësimin e rezultateve të nxënimit të temës mësimore. Mësuesi u lë nxënësve kohë të përmirësimin çfarë kanë mësuar, si dhe u kërkon të nxjerrin në pah

	drejtimet ku kanë nevojë për përmirësim. Vlerësimi i mësuesi është i përqendruar në pak nxënës dhe pjesa më e madhe e klasës mbetet pa vlerësim. Nxënësit paraqesin vështirësi për të treguar çfarë kanë të paqartë.	paraqesin vështirësi për të kuptuar se çfarë kanë të paqartë apo të pakuptuar prej tyre. Të pakta janë rastet kur mësuesi bën vlerësime pozitive rreth punës që kryejnë nxënësit.	prej tyre. Herë pas here, mësuesi u bën nxënësve vlerësime pozitive rreth punës që kryejnë. Nxënësit i tregojnë vështirësitë kur pyeten nga mësuesi.	çfarë nuk kanë kuptuar. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi bën vlerësime pozitive rreth punës që kryejnë, duke i nxitur dhe stimuluar vazhdimisht që të bëjnë më të mirën. Nxënësit kuptojnë vështirësitë dhe kërkojnë ndihmë kur kanë nevojë. Mësuesi stimulon edhe vetëvlerësimin e nxënësve. Mësuesi vlerëson marrëdhëniet dhe cilësitë e tjera të nevojshme të punës në grup.
Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të	0 – 1 pikë Vlerësimi i mësuesit lidhet me rezultatet që kishte tema e mësimit. Mungon nxitja e vlerësimeve për njëri-tjetrin, për	2 – 3 pikë Mësuesi bën vlerësime të nxënësve pasi ata mbarojnë një veprimtari. Vlerësimi lidhet me përmbushjen e rezultateve të	4 pikë Gjatë orës së mësimit mësuesi bën vazhdimisht vlerësime duke iu referuar niveleve të arritjes së nxënësve. Mësuesi i vëzhgon	5 pikë Mësuesi bën vlerësime duke përdorur teknika të ndryshme dhe duke iu referuar niveleve të arritjes së nxënësve. Mësuesi i vëzhgon

<p>arritjes</p>	<p>veten dhe për punën në grup. Mësuesi përqendrohet të bëjë vlerësim vetëm për nxënësit që kishte planifikuar.</p>	<p>temës së mësimit. Herë-herë mësuesi ndalet teksa nxënësit punojnë dhe u drejton pyetje rreth asaj që po bëjnë. Mësuesi bën vlerësime për gjëra që nxënësit duhet të përmirësojnë në të ardhmen. Ka raste kur nxënësit nxiten t'i bëjnë vlerësime njëri-tjetrit.</p>	<p>nxënësit gjatë kohës që punojnë dhe i nxit me pyetje të ndryshme. Mësuesi jep në fillim vlerësime pozitive, por i ka të kufizuara vlerësimet për gjëra që nxënësi duhet të përmirësojë në të ardhmen. Nxënësit i bëjnë vlerësime njëri-tjetrit e po kështu veprojnë edhe për veten duke u vënë në rolin e mësuesit.</p>	<p>nxënësit gjatë gjithë kohës që punojnë, i dëgjon me vëmendje dhe i nxit me pyetje të ndryshme. Për çdo nxënës mësuesi kujdeset të japë në fillim vlerësime pozitive dhe më pas vlerësime për gjëra që nxënësi duhet të përmirësojë në të ardhmen. Nxënësit janë të motivuar për të mësuar dhe e përfundojnë çdo detyrë që jep mësuesi, përfshihen në të gjitha veprimtaritë dhe ndihen mirë me njëri-tjetrin.</p>
<p>Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënës dhe nevojave të</p>	<p>0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra të njëjta për të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh stilet e të nxënës apo nevojat e tyre</i></p>	<p>2 – 3 pikë Mësuesi i përfshin nxënësit në veprimtari të përbashkëta. Pak prej tyre u përkasin nevojave</p>	<p>4 pikë Mësuesi njeh nxënësit e klasës dhe veprimtaritë e planifikuara u përkasin nevojave të tyre dhe stileve të të nxënës.</p>	<p>5 pikë Mësuesi njeh nxënësit e klasës dhe ka planifikuar edhe detyra të diferencuara, të cilat u përkasin nevojave të tyre</p>

nxënësve	<i>individuale.</i>	individuale dhe stileve të ndryshme të nxënësve. Jo të gjithë nxënësit i realizojnë detyrat e dhëna nga mësuesi.	Mësuesi mundua që të gjithë nxënësit të ndiheshin mirë. Gjatë orës së mësimit pjesa më e madhe e nxënësve u përfshinë në kryerjen e detyrave të klasës.	dhe stileve të nxënësve. Mësuesi përshtati mësimdhënies dhe të gjitha veprimtaritë dhe bëri të mundur që të gjithë nxënësit të ndiheshin mirë. Gjatë orës së mësimit të gjithë nxënësit u përfshinë dhe kryen detyrat e dhëna nga mësuesi.
-----------------	---------------------	--	---	--

Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)

Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	0 – 1 pikë	2 pikë	3 pikë	4 pikë
	Mësuesi përdor shumë pak mjete mësimore, didaktike. Mungesa e tyre e kufizoi nga njëra anë mësuesin për konkretizimin e mësimit dhe nga ana tjetër nxënësit për kryerjen e veprimtarive dhe përmbushjen e rezultateve të të	Mësuesi përdor pak mjete mësimore, ndërkohë që tema e mësimit ka hapësirë edhe për materiale të tjera didaktike. Mungesa e mjeteve dhe e materialeve të nevojshme kufizoi deri diku mësuesin dhe nxënësit për	Mësuesi ka siguruar materiale dhe mjete që lidhen me veprimtari të caktuara të orës së mësimit. Nëpërmjet tyre, tema e mësimit është e konkretizuar dhe nxënësit janë të nxitur të ndjekin me interes çdo etapë të orës së	Mësuesi ka siguruar të gjitha materialet dhe mjetet që lidhen me temat e mësimit. Nëpërmjet tyre ai konkretizon mësimin dhe lehtëson të nxënësve.

	nxënit.	realizimin e veprimtarive dhe përmbushjen e rezultateve të nxënit të temës së mësim.	mësim.	
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve	0 – 1 pikë	2 pikë	3 pikë	4 pikë
	Mësuesi nuk përdor mjete digjitale gjatë zhvillimit të temës së mësim. Mësuesi nuk ka dijeni nëse nxënësit kanë ose jo aftësi digjitale të cilat mund t'i përdorin në kryerjen e detyrave të ndryshme.	Mësuesi i përdor me ndihmën e tjerëve mjetet digjitale por herë-herë situata i doli jashtë kontrollit. Nxënësit nuk arritën të vinin në zbatim aftësitë e tyre digjitale.	Mësuesi ka siguruar pajisjet dhe mjetet digjitale që i duhen për zhvillimin e orës së mësim. Ai i përdori me pak vështirësi mjetet dhe u përpoq t'i mbante nxënësit të përfshirë në mësim. Mësuesi u përpoq të përfshinte nxënësit me aftësi digjitale në disa momente të orës së mësim. Mësuesi u dha nxënësve detyrë për ta realizuar me mjete digjitale.	Mësuesi ka siguruar pajisjet dhe mjetet digjitale që i duhen për zhvillimin e orës së mësim. Ai i përdori mjetet me siguri të plotë dhe mbajti gjallë interesin e nxënësve për çdo veprimtari. Mësuesi arriti të përdorë aftësitë digjitale të nxënësve në kryerjen e detyrave të klasës. Mësuesi i nxit nxënësit të realizojnë detyra duke përdorur mjetet digjitale.